

KONTRATË SHITJE
E PJESËMARRJES NË KAPITALIN TË SHOQËRISË
“Agromark” SHPK

Sot më 13/06/2018, palët kontraktuese si më poshtë vijon:

Shitës: z. **Klodjan Allajbeu**, Shtetas Shqiptar, i biri i Fadilit, lindur më 21.04.1978, në Berat, Shqipëri, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotërues i dokumentit të identifikimit me nr. personal N. H80421164I, aksionar i vetëm i shoqërisë Agromark shpk

dhe

Blerës: **VENDEKA EUROPEAN INVESTMENTS B.V.** një shoqëri Holandeze, e regjistruar në Dhomën Holandeze të Tregtisë, nr. regjistrimi **CC1 66037182**, me adresë të regjistruar në: Nassaulaan 2 A, 2514JS'-Gravenhage, përfaqësuar në këtë kontratë nga ortaku i vetem i saj, z. **Klodjan Allajbeu**, Shtetas Shqiptar, i biri i Fadilit, lindur më 21.04.1978, në Berat, Shqipëri, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotërues i dokumentit të identifikimit me nr. personal N. H80421164I;

Së bashku më poshtë “Palët”,

Baza Ligjore: Neni 73 i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare”, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, neni 705 dhe vijuese;

DUKE QENË SE, shitësi është pronari i regjistruar i 100% të pjesëmarrjes në Kapitalin e shoqërisë Agromark shpk.

DUKE QENË SE, Shitësi dëshiron ti transferojë 100% pjesëmarrjen e tij në Kapitalin e shoqërisë Agromark shpk Blerësit Vendeka European Investments B.V. sipas kushteve te përcaktuara në këtë kontratë Shitje.

DUKE QENË SE, Blerësi nga ana e tij dëshiron të blejë Pjesëmarrjen e Kapitalit sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë të shitjes së pjesëmarrjes të Kapitalit.

PËR KËTË ARSYE ËSHTË RËNË DAKORD S si më poshtë vijon:


Përkufizime dhe interpretimë

1.1 Kudo që përdoret në këtë kontratë (duke përfshirë Anekset), vetëm nëse është përcaktuar ndryshe ose konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Kontrata” ose “kjo Kontratë” nënkupton këtë Kontratë, duke përfshirë të gjitha Anekset dhe çdo amendim ose shtojce te saj.

“Data e nënshkrimit të transaksionit” nënkupton datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate nga Palët.

“Data e mbylljes” nënkupton datën në të cilën Blerësi realizon pagesën e çmimit të blerjes siç përcaktohet në Nenin 2.



“Barrësimet”	do të thotë çdo pagesë, pretendim, interes, barrë, opzion, peng, interes sigurie, të drejta te refuzimit të parë, e drejtë blerje ose kufizim i çdo lloji, përveç atyre që lindin sipas ligjit në fuqi dhe / ose dokumenteve themeluese të Shoqërisë.
“Pjesëmarrja” “Çmimi i blerjes”	nënkupton pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë “Agromark” shpk. nënkupton çmimin e Shitjes së pjesëmarrjes, të pagueshmë nga Blerësi për Shitësin, shuma e së cilës përcaktohet në përputhje me nenin 2 të kësaj kontrate.
“Ditë pune”	nënkupton çdo ditë kalendarike, përveç të shtunave, të dielave dhe ditëve të klasifikuara si pushime sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë, në të cilat bankat janë të hapura për operacione të rregullta bankare.
“QKB”	nënkupton Qendrën Kombëtare të Biznesit, autoriteti publik ku është organizuar dhe mbajtur regjistri i shoqërive tregtare në Shqipëri, sipas ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të modifikuar
“Transaksion”	do të thotë shitjen nga Shitësi, dhe blerjen nga Blerësi i 100% të pjesëmarrjes sipas kësaj kontrate.
“Taksë” ose “Tatim”	nënkupton të gjitha taksat, detyrimet, tarifat, ose taksat e tjera qeveritare, duke përfshirë të gjitha taksat kombëtare, federale, shtetërore, lokale, bashkiake, të huaja, dhe çdo tatim tjeter mbi të ardhurat, fitimet, kapitalin, pronën, ose vlerën e shtuar, si dhe taksat e akcizës, tarifat e licencave, taksat sociale, Tatimin mbi të ardhurat në burim, dhe taksat e tjera, vlerësimet tatimore, mjetet, tarifat, detyrimet ose tarifat e tjera qeveritare të çdo lloji (të paguara direkt ose me zbritje; të cilat mund ose nuk mund të kërkojnë paraqitjen e një deklarate tatimore, të vendosura nga ndonjë autoritet tatimor apo tjeter).

1.2 Çdo fjalë që është në njëjës do të konsiderohet të përfshijë shumësin (dhe anasjelltas) dhe çdo fjalë e shënuar në një gjini të veçantë do të konsiderohet të përfshijë të gjitha gjinitë dhe çdo kusht që nënkupton çdo formë të personit apo njerëzve do të konsiderohet të përfshijnë si personat juridikë (si shoqëritë), ashtu edhe personin fizik (dhe anasjelltas)


1.3 Referenca për nenet e kësaj Kontrate do të përfshijë anekset e së njëjtës Kontratë (përveç rastit në të cilin konteksti përcakton ndryshe). Anekset e kësaj Kontrate janë pjesë përbërëse e saj.

1.4 Titujt e neneve dhe paragrafëve në këtë kontratë janë vetëm për lehtësi dhe nuk duhet të merren parasysh në interpretimin e kësaj kontrate

Neni 1 – Objekti i Kontratës

Objekti i kësaj Kontrate është shitja e 100% të Pjesëmarrjes së zotëruar nga ortaku Klodjan Allajbeu, ne shoqërinë Agromark shpk përkatesisht tek shoqëria e të drejtës holandeze “Vendeka European Investments B.V”, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë.

Neni 2 – Çmimi i blerjes



Pjesëmarrja e Kapitalit është shitura në vlerën 100 Leke në total.

Çmimi do të paguhet plotësisht nga Blerësi tek Shitësi përmes transfertës bankare në llogarinë bankare të treguar nga Shitësi brenda pesë (5) ditëve pune pas Datës së Nënshkrimit të Transaksionit.

Pagesa e të gjithë tatimeve dhe tarifave të tjera që paguhen në lidhje me këtë Kontratë do të janë përgjegjësi e Shitësit, i cili në pajtim me ligjin në fuqi ka detyrimin të vlerësojë dhe / ose të paguajë taksat dhe tarifat përkatëse.

Shitia është absolute dhe përfshin të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me pjesëmarrjen, duke përfshirë, por pa u kufizuar në të gjitha të drejtat për dividendët, kapitalin dhe të drejtën e votës dhe për shuangjen e dyshimit, çdo dividend që është i detyrueshëm, por që nuk është paguar ende, do ti paguhet Blerësit.

Neni 3 - Përfaqësimi dhe garancitë e Shitësit

3.1 Shitësi garanton se ai është pronari i vërtetë i Pjesëmarrjes së Kapitalit dhe ka absolutisht të drejtë për të gjithë përsitimet e saj.

3.2 Personi i cili nënshkruan këtë Kontratë në emër të Shitësit ka autoritetin e plotë për ta bërë këtë dhe kapaciteti ligjor i Shitësit në lidhje me ekzekutimin dhe përbushjen e kësaj Kontrate nuk është i kufizuar.

3.3 Shitësi ka marrë të gjitha lejet dhe miratimet që Shitësi është i detyruar të sigurojë, marrë ose të ketë në lidhje me ekzekutimin e Kontratës dhe ekzekutimin e Transaksionit, dhe këto leje dhe miratime janë në fuqi dhe të vlefshme.

3.4 Ekzekutimi i kësaj Kontrate dhe ekzekutimi i Transaksionit nga Shitësi nuk shkel ndonjë akt ligjor apo rregullore të zbatueshme për Shitësin dhe nuk përfshin shkeljen e ndonjë rregulloreje, vendimi ose urdhri të ndonjë organi qeveritar ose të një institucioni të qeverisjes vendore.


3.5 Kjo Kontratë përcakton detyrime të vlefshme dhe ligjore të Shitësit, të zbatueshme në përputhje me kushtet e kontratës.

3.6 Pjesëmarrja e Kapitalit i përket ligjërisht pronarit dhe është paguar plotësisht në pajtim me ligjin në fuqi dhe siguron një tërësi të plotë dhe të pakufizuar të të drejtave.

3.7 Pjesëmarrja e Kapitalit nuk është subjekt i (nuk është e barrësuar) të drejta ose pretendime të palëve të treta ose Barrësuar, sekuestruar ose ka ndalim të realizimit të transaksioneve të vendosura me vendim të një gjykate ose një organi të autorizuar shtetëror dhe nuk janë subjekti i ndonjë gjykimi dhe / ose mosmarrëveshje administrative, arbitrazhi ose procedure jashtë gjyqësore.

3.8 Nuk ka prokura të vlefshme ose ndonjë të drejtë apo kompetence tjetër të caktuar (të dhënë) nga Shitësi në lidhje me pjesëmarrjen e Kapitalit (tërësisht ose pjesërisht).

3.9 Shitësi nuk është i përfshirë në ndonjë mosmarrëveshje sa i përket pjesëmarrjes së Kapitalit. Nuk ka mosmarrëveshje lidhur me pjesëmarrjen e Kapitalit. As Shitësi, as Pjesëmarrja e Kapitalit nuk janë



subjekt i ndonjë gjykimi apo urdhri në fuqi që do të ndalonte Shitësin nga përmbushja e kushteve të Kontratës.

3.10 Nuk ka marrëveshje midis Shitësit dhe Palëve të Treta në lidhje me:

- (i) pronësinë, votimin ose transferimin e pjesëmarries së Kapitalit (pjesëve të pjesëmarries së Kapitalit);
- (ii) të drejtën për emërimin e anëtarëve të Këshillave të shoqërisë ose të Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë.

3.11 Pasqyrat financiare të shoqërisë, të datës 31 dhjetor 2017, të cilat i janë dorëzuar Blerësit dhe janë bashkangjitur kësaj Kontrate si Shtojca 1, janë të ligjshme dhe të përgatitura në përputhje me standartet e aplikueshme financiare.

Nga data e nënshkrimit deri në datën e mbylljes, veprimtaria e shoqërisë ka ndjekur rutinën e saj normale dhe nuk janë bërë ndryshime në përbajtjen, strukturën dhe vlerën e aktiveve dhe pasiveve siç tregohet në Pasqyrat financiare dhe nuk ka shpërdorim material të vlerës së aktiveve të Paluajtshme neto të shoqërisë (përveç amortizimit normal dhe zhvlerësimit) sipas vlerësimit të përdorur për Pasqyrat financiare.

3.12 Shoqëria ka depozituar në kohën e duhur të gjitha deklaratat fiskale periodike dhe vjetore të parashikuara nga legjislationi fiskal në fuqi në këtë drejtim. Deklarata fiskale në fjalë është përgatitur në mënyrë të rregullt dhe të gjitha detyrimet fiskale të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të pagueshme janë paguar plotësisht dhe në kohë.

Neni 4 - Përfaqësimet dhe garancitë e Blerësit

4.1 Blerësi është një person juridik i inkorporuar dhe regjistruar. Blerësi ka kapacitetin e plotë juridik dhe autoritetin e nevojshëm për të lidhur këtë Kontratë dhe për të përmbushur detyrimet e tij dhe për të kryer transaksionet e parashikuara nga kjo Kontratë.

4.2 Për qëllime të ekzekutimit dhe përmbushjes së kësaj Kontrate, Blerësi vepron në emër të vet dhe nuk është ndërmjetës, agjent ose përfaqësues i ndonjë Palë të Tretë.

4.3 Individ i që nënshkruan këtë Kontratë në emër të Blerësit ka autoritetin e plotë për ta bërë këtë dhe kapaciteti ligjor i Blerësit në lidhje me ekzekutimin dhe përmbushjen e kësaj Kontrate nuk është i kufizuar.

4.4 Blerësi nuk i nënshtronet ndonjë gjykimi ose urdhri që aktualisht është në fuqi që do të ndalonte Blerësin nga përmbushja e kushteve të Kontratës.

4.5 Blerësi ka marrë të gjitha lejet dhe miratimet që Blerësi është i detyruar ti sigurojë, ti marrë ose ti ketë për t'u marrë në lidhje me ekzekutimin e Kontratës dhe ekzekutimin e Transaksionit dhe se këto leje dhe miratime janë në fuqi dhe të vlefshme.

4.6 Ekzekutimi i kësaj Kontrate dhe ekzekutimi i Transaksionit nga Blerësi nuk shkelin ligjet ose rregulloret e zbatueshme ndaj Blerësit ose ndonjë prej anëtarëve të tij dhe nuk përfshijnë shkeljen e ndonjë rregulloreje, vendimi ose urdhërimi të ndonjë organi qeveritar ose institucion vendor.



4.7 Kjo Kontratë përcakton detyrime të vlefshme dhe ligjore të Blerësit, të cilat duhet të kryhen në përputhje me kushtet e Kontratës.

4. Blerësi deklaron se është njohur për shoqerinë "Agromark" shpk, gjendjen financiare dhe ligjore të saj dhe i njeh dhe pranon ato si të sakta dhe në përputhje me vullnetin e tij:

- heq dorë në mënyrë të pakthyeshme nga çdo e drejtë për të iniciuar në të ardhmen çdo procedurë ose veprim tjetër ligjor ndaj Shitësit dhe / ose përfaqësuesve të tij ligjor, që mund të rrjedhin nga çdo shkak / motiv apo fakt / çështje.

- liron dhe shkarkon në mënyrë të pakthyeshme Shitësin dhe / ose përfaqësuesit e tij ligjor nga të gjitha përgjegjësitë në lidhje me çfarëdo deklarate apo përfaqësim të Shitësit të bërë përparrë lidhjes së kësaj Kontrate, dhe atributet e dhëna për pjesëmarrjen e shitur të kapitalit dhe gjendjen financiare të Shoqërisë.

Neni 5 - Të drejtat dhe detyrimet e Blerësit

5.1 Blerësi është i detyruar të paguajë çmimin e blerjes sipas Nenit 2 të kësaj Kontrate.

5.2 Blerësi do të marrë në dorëzim çdo pasuri të Shoqërisë "Agromark" shpk, si dhe çdo faturë që vërteton të drejtat dhe detyrimet që Shoqëria "Agromark" shpk ka me palët e treta.

5.3 Blerësi ka të drejtë të arkëtojë çdo hyrje të papaguar dhe është i detyruar të paguajë çdo detyrim të shoqërisë "Agromark" shpk ndaj palëve të tretë siç detajohet në procesverbalin e pranuar dhe të nënshkruar nga të dyja pjesët para nënshkrimit të kësaj Kontrate

5.4 Blerësi ka për detyrë të depozitojë Kontratën aktuale dhe dokumentacionin përkatës në Regjistrin Tregtar në QKB, Tirancë dhe të njoftojë për modifikimet e Shoqërisë: Zyrën e Përgjithshme dhe Lokale të Taksave dhe Tatimeve, ISKSH dhe çdo institucion tjetër të kërkuar me ligj.

Neni 6 - Të drejtat dhe detyrimet e Shitësit

6.1 Shitësi ka të drejtë të arkëtojë çmimin e blerjes nga Blerësi sipas Nenit 2 të kësaj Kontrate.

6.2 Shitësi është i detyruar të dorëzojë asetet (inventarin e makinerive dhe pasurive të luajtshme) dhe të gjitha dokumentet origjinale të akteve të themelimit, licencat profesionale, aktet tatimore, si dhe të gjitha faturat fiskale të shitjes ose blerjes së mallrave nga / për palët e treta.

6.3 Shitësi zhvishet nga çdo e drejtë dhe detyrim që rrjedh nga cilësia e aksionarit të kësaj shoqërie, pas nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe regjistrimit të saj në regjistrin tregtar në QKB.

Neni 7 - Klauzola kundër korruptionit

Blerësi ose çdo palë që vepron në emër të saj, duke përfshirë çdo drejtor, partner, menaxher ose punonjës të Blerësit:

(i) deri në datën e nënshkrimit të transaksionit, nuk ka realizuar ndonjë pagesë të paligjshme, të drejtpërdrejtë ose jo, për ndonjë zyrtar ose punonjës, të huaj ose të qeverisë,

- (ii) nuk ka marrë pjesë dhe nuk do të marrë pjesë në shkelje, nga shoqëria "Agromark" shpk ose Blerësi, për ndonjë ligji anti-korrupsion, të zbatueshëm për Palët, që ndalon pagesën e ryshfeteve për zyrtarët ose punonjësit publikë,
- (iii) nuk ka paguar asnjë ryshfet ose nuk ka bërë ndonjë pagesë tjetër të paligjshme, duke përfshirë edhe në lidhje me aktivitetet e shoqërisë "Agromark" shpk, dhe
- (iv) nuk ka fshehur nga Shitësi ndonjë informacion që mund të ndikojë materialisht në ligjshmërinë e ekzekutimit të kësaj Kontrate dhe ekzekutimin e Transaksionit.

Neni 8 - Forca madhore

8.1 Asnjë Palë nuk do të jetë përgjegjëse në rast të mospërmbushjes, si dhe kryerjes së vonuar ose të papërshtatshme të çdo detyrimi sipas kësaj Kontrate, nëse një mos realizim i tillë, vonesë ose performancë e papërshtatshme rezulton vetëm nga fillimi dhe / ose efekti i një force madhore që drejtpërdrejtë ndikon në përmbushjen e detyrimeve.

8.2. Pala e prekur nga forca madhore, pa vonesë, por jo më vonë se dy (2) ditë pune pas fillimit të forcës madhore, njofton Palën tjetër me shkrim përrethanat dhe pasojat e tyre (me njoftim Marrje) dhe të marrë të gjitha masat e mundshme për të zbutur pasojat negative të forcës madhore të lartpërmendur.

8.3. Nëse rrethanat e forcës madhore që pengojnë një nga Palët të kryejë detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate vazhdojnë për më shumë se 15 ditë pune, kjo kontratë do të përfundojë automatikisht dhe secila Palë do ti kthejë Palës tjetër gjithçka që është marrë sipas kësaj Kontrate.

Neni 9 - Konfidencialiteti

9.1 Të gjitha informacionet teknike, tregtare, financiare dhe të tjera, të siguruara nga palët për njëritjetrin dhe që lidhen me ekzekutimin ose përmbushjen e kësaj Kontrate, janë konfidenciale.

9.2 Palët do të marrin të gjitha masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar zbulimin e informacionit të marrë Palëve të Treta. Palët do të kenë të drejtën ta zbulojnë këtë informacion Palëve të Treta në rastet kur palët e tillë janë të angazhuara në aktivitete që kërkojnë njojen e një informacioni të tillë, por vetëm në masën e kërkuar për përmbushjen e kësaj Kontrate.

9.3 Kufizimet në zbulimin e informacionit nuk do të zbatohen për informacionet që janë në dispozicion të publikut, informacionet që më vonë bëhen publik pa faj të Palëve, informacion që duhet t'u dorëzohet organeve shtetërore sipas ligjit dhe vetëm në lidhje me punonjësit e këtyre organeve, ose informacion që i bëhet i njojur Palës nga burime të tjera para marrjes së saj nga Pala tjetër.

9.4 Barra e vërtetimit të shkeljes së dispozitave të këtij Neni 9 do ti mbetet Palës që pretendon se ka ndodhur një shkelje e tillë.

9.5 Dispozitat e paragrafëve 9.1-9.4 të kësaj kontrate nuk do të zbatohen për informacionet që i nënshtrohen zbulimit të detyrueshëm nga Blerësi dhe / ose bashkëpunëtorët e tij ose Shitësi dhe / ose bashkëpunëtorët e tij, sipas rregullave dhe kërkesave të shkëmbimit përkatës të letrave me vlerë kur letrat me vlerë të Blerësit ose anëtarëve të saj tregtohen sipas ligjit në fuqi.

Neni 10 – Njoftime

Çdo njoftim i paraqitur nga një Palë në këtë Kontrate për çdo Palë tjetër në këtë Kontratë, kur një njoftim i tillë lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me këtë Kontratë, duhet të bëhet me shkrim dhe të nënshkruhet nga Pala që dorëzon njoftimin ose përfaqësuesi i tij i autorizuar. Këto njoftime duhet të transmetohen ose ti dorëzohen Palës përkatëse në adresën e saj të dhënë më poshtë (përveç nëse pala përkatëse njofton paraprakisht Palën tjetër lidhur me ndryshimin e adresës)

(a) nëpërmjet postës së regjistruar

(b) duke përdorur një shërbim të dorëzimit të njoftimit i cili regjistron datën, vandin dhe marrjen e dërgesës.

Çdo njoftim i dorëzuar në këtë mënyrë do të konsiderohet se është dorëzuar rregullisht në kohën e dorëzimit; dokumentet e dorëzuara pas orës 18:00 në një ditë pune, ose të dorëzuara në çdo ditë që nuk konsiderohet si ditë pune, do të konsiderohen se janë dorëzuar në orën 9:00 të ditës së ardhshme të punës

(c) nëpërmjet email.

Adresat për komunikimin midis Palëve do të jenë si më poshtë:

SHITËSI:

Klodjan Allajbeu

BLERËSI:

Vendeka European Investments B.V

Neni 11 - Dispozita të tjera

11.1. Asnjë Palë e Kontratës nuk ka të drejtë të caktojë të drejtat ose detyrimet e saj sipas kontratës për çdo Palë të Tretë.

11.2. Çdo dhe të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Kontrate do të jenë të vlefshme vetëm nëse kryhen me shkrim dhe nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve. Shtojcat janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate

11.3. Kjo Kontratë përbën të gjithë marrëveshjet midis Palëve në lidhje me objektin e kësaj Kontrate dhe anulon dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet, angazhimet dhe përfaqësimet e tjera që mund të jenë bërë nga Palët para datës së nënshkrimit të Transaksionit.

11.4. Kjo Kontratë është hartuar në gjuhën angleze dhe shqipe, në tri (3) kopje me fuqi të njëjtë ligjore, një kopje e kontratës për Shitësin dhe një kopje për Blerësin. Secila kopje e kontratës është e numëruar, e lidhur dhe e vërtetuar me nënshkrimet e Palëve.

11.5 Në rast se ndonjë nen (ose ndonjë pjesë e ndonjë nenit) do të konsiderohet i paligjshëm ose i pavlefshëm nga një gjykatë kompetente ose autoritet tjetër ligjor atëherë kjo do të ketë efekt të pavlefshëm dhe do të përjashtojë vetëm atë nen (ose pjesë të atij nenit) dhe nuk do ta zhvlerësojë këtë kontratë të shitjes në tërsësi.

11.6 Çdo vonesë ose dështim për të zbatuar kushtet e kësaj kontrate shitje dhe çdo vonesë për të vepruar në shkelje të afatit të saj nga cilado palë nuk përbën heqje dorë nga këto të drejta.

11.7 Secila palë garanton se nuk do të ndërmarrri ndonjë veprim që mund të dëmtojë, pengojë ose të ndikojë negativisht në detyrat e palës tjetër të përcaktuar në këtë Kontratë shitjeje.

11.8 Kjo Kontratë do të lidhet dhe do të jetë në dobi të pasardhësve përkatës dhe personave të caktuar të palëve.

Neni 12 - Dispozitë kalimtare

Cdo kontratë qiraje, pune dhe / ose e çdo kontrate ose akt tjetër ligjor, i nënshkruar nga shoqëria "Agromark" shpk para hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate, do të vazhdojë të jetë në fuqi deri në momentin në të cilin Palët do të vendosin ndryshe.

Neni 13 - Ligji Drejtues, Mosmarrëveshjet dhe Arbitrazhi

Është rënë dakord se:

13.1 Ky kontratë shitjeje bëhet sipas juridiksonit ekskluziv të ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

13.2 Mosmarrëveshjet në këtë kontratë shitjeje i nënshtrohen juridiksonit ekskluziv të gjykatave të Tiranës, Shqipëri.

Neni 14 - Hyrja në fuqi


Kjo kontratë e Shitje e Pjesëmarjes së kapitalit është përpiluar në katër kopje autentike, në gjuhën shqipe dhe angleze, të shkruara në tete flete nga te dyja faqet dhe hyn në fuqi sot, më ____ / ____ / 2018

Kësaj kontrate i bashkëngjiten dokumentet e mëposhtme:

- Bilanci i Shoqërisë "Agromark" shpk, deri më datë 31 Dhjetor 2017
- Vërtetim nga Regjistri i Barrëve Siguruese
- Vërtetim nga Zyra e Tatimeve;
- Dokument identifikimi për përfaqësuesit e Palëve;

Palët Kontraktuese

Klodian Allajbu
Për shitësin



Klodian Allajbu
Për Blerësin

